



Npi – 01/75 datë: 21.02.2025

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) si dhe nenin 17 shkronja (e) të Ligjit Nr.03/L-040 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008); Nenin 16 paragrafi 4 shkronja (b), nenin 19 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.02/L-53 për Gjuetinë; Udhëzimin Administrativ të (MA) Nr.10/2007 për kriteret e caktimit të zonave dhe procedurat për themelimin e vendgjuetive; Statutin e Komunës së Shtimes Nr.01-06/1636 të datës 03.09.2008; Si dhe mbi bazën e Propozim-Vendimit Nr.12/04 të datës 18.02.2025, të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për Anulimin e Vendimit të Kuvendit Npi-01/346 të datës 31.10.2024 për caktimin e Vendgjuetisë së përbashkët në territorin e komunës së Shtimes sipas Rekomandimit të MBPZHR – Nr.4321/2 të datës 03.11.2024. Kuvendi i Komunës të Shtimes, në seancën e mbajtur më: 24.02.2025, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT Npi-01/346 TË DATËS 31.10.2024 PËR CAKTIMIN E VENDGJUETISË SË PËRBASHKËT NË TERRITORIN E KOMUNËS SË SHTIMES

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -II- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: 24.02.2025, unanimisht miratoi, Vendimin për ANULIMIN e Vendimit të Kuvendit Npi-01/346 të datës 31.10.2024 për caktimin e vendgjuetisë në territorin e komunës së Shtimes.

II

A r s y e t i m: Kuvendi ka marrë vendim sikurse në dispozitiv, duke marrë për bazë Rekomandimin e Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural e cila me shkresën Nr.4321/2 të datës 03.11.2024 i ka rekomanduar Kuvendit të Komunës së Shtimes Rishqyrtimin e Vendimit Npi-01/346 të datës 31.10.2024 për caktimin e Vendgjuetisë së përbashkët në territorin e komunës së Shtimes, me arsyetimin se nuk është në përputhje të plotë me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi